



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

N J O F T I M

Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë ju njofton se, duke filluar nga data 18.06.2026, do të hyjnë në fuqi disa ndryshime në rregullimin teknik të komunikacionit në rrugët urbane "Ahmet Kaçiku" dhe "Brigada 161", me qëllim të përmirësimit të qarkullimit të automjeteve, rritjes së sigurisë në komunikacion dhe menaxhimit më efikas të fluksit të lëvizjes së të gjithë pjesëmarrësve në këtë zonë.

Sipas rregullimit të ri të komunikacionit, qasja (hyrja) me automjete në rrugën urbane "Ilmi Hashani" dhe në rrugët tjera anësore pranë qendrës tregtare "The Village" do të lejohet vetëm nga rruga urbane "Brigada 161". Hyrja e automjeteve nga drejtimi i rrugës urbane "Ahmet Kaçiku" nuk do të lejohet më, ndërsa do të mundësohet vetëm dalja.

Këto ndryshime nuk vlejné për shërbimet e ushqimit të shpejtë "KFC" dhe "Burger King", për të cilat hyrja dhe dalja do të mbeten të mundshme sipas qasjeve të përcaktuara për këto biznese.

Lusim të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion që të respektojnë sinjalizimin e ri rrugor dhe të përshtatin lëvizjen e tyre sipas rregullimit të ri, në mënyrë që të sigurohet një qarkullim i rregullt dhe i sigurt për të gjithë.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.